



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)

Fakulteti:	Ekonomik	
Programi:	Biznes dhe menaxhment	
Specializimi:	Specializimi: Banka Financa dhe Kontabilitet	
Niveli:	Bachelor (BSc)	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Menaxhimi ndërkulturor	
Statusi i lëndës:	Zgjedhore	(Obligative apo zgjedhore)
Semestri:	IV	(Dimëror / Veror)
Fondi i orëve:	2+1	(Sipas programit të aprovuar)
ECTS:	4	(Sipas programit të aprovuar)
Orari/Salla		
Viti akademik:	2021/2022	
Mësimdhënës/e:	Prof. Asoc. Dr. Ajtene Avdullahi	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Professor	Asistent/e
Email:	ajtene.avdullahi@umib.net	
Telefon:	+38345/403200	

PERMB AJTJE

Kjo lëndë synon të zhvilloj tek studentët një ndërgjegjësim më të madh për ndryshimin e mjedisit global dhe të kuptuarit e implikimeve për biznesin dhe menaxhimin ndërkombëtar. Moduli u mundëson studentëve që të studiojnë konceptet dhe teoritë kryesore në menaxhimin ndërkulturor, si dhe të pregaditen që të pasqyrojnë aftësitë e tyre në kontekstin multikulturor. Lënda fokusohet në procesin e menaxhimit nga këndvështrimi ndërkulturor, duke marrë parasysh veçoritë kulturore dhe metodat e ndryshme të menaxhimit mbi "bashkimet kulturore" në procesin e zgjerimit të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimin e projekteve shumëkombëshe. Njohja e dallimeve ndërkulturore dhe përdorimi praktik i tyre rrit efikasitetin e ndërveprimit ndërmjet përfaqësuesve të kulturave të ndryshme kombëtare dhe mund të konsiderohet si një nga kompetencat thelbësore të menaxherit të suksesshëm në mjedisin global.

QËLLIM I	Qëllimi kryesor i lëndës "Menaxhimi ndërkulturor" është studimi i një qasjeje thelbësisht të re në menaxhimin e kompanisë, duke marrë parasysh dallimet ndërkulturore dhe krijimin e një sistemi njohurish të nevojshme për menaxhimin e suksesshëm të kompanisë në mjedisin global. Lënda synon ofrimin e kornizave konceptuale për të kuptuar sistematikisht kontekstet ndërkulturore të biznesit ndërkombëtar dhe konceptet teorike që lidhen me kulturën, sinergjitë kulturore dhe dallimet. Gjithashtu ky modul ka për qëllim lidhjen me fushat përkatëse të studimit dhe modulet tjera si Biznesi Ndërkombëtar etj, për të inkurajuar mësimin ndërdisiplinor dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive të bazuara gjerësisht në lidhje me çështjet globale të rëndësishme për Biznesin Ndërkombëtar.	
ARRITSHMËRI A	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: • <u>Të kuptojnë</u> mjedisin global të biznesit i cili është vazhdimisht në ndryshim, çështjet e bizneseve të reja ndërkulturore (të lindura globale), dhe implikimet për menaxhimin të ndërmarrjes së re, • <u>Të përshkruajnë</u> një sërë argumentesh kulturore në lidhje me nevojën për përgjegjësi korporative dhe sociale dhe sjellje etike në biznes, • <u>Të praktikojnë</u> aftësitë komunikuese në krijimin e ekipeve, lidhshirësit motivues dhe negocimit në mjedis multikulturor, • <u>Të analizojnë</u> strategjitë e zgjidhjes së problemeve për çështjet ndërkulturore dhe të paraqesë argumente në mbështetje të sjelljes kulturalisht të ndjeshme dhe të përgjegjshme shoqërore në biznes, • <u>Të vlerësojnë</u> në mënyrë kohezive në një ekip ndërkulturor dhe demonstroi të kuptuarit e strategjive të zgjidhjes së problemeve në ekipe të ndryshme (diverse) dhe • <u>Të ideojnë</u> në mënyrë kritike dhe krahasuese dallimet kulturore duke marrë parasysh ndikimin në organizatat globale të biznesit.	
PROGRAMI	Javët	Temat
	Java - I	Prezantimi i lëndës, syllabusit dhe literaturës
	Java - II	Kultura dhe dinamikat e saj
	Java - III	Globalizimi: Rrënjët evolucionare dhe versioni bashkëkohor
	Java - IV	Menaxhimi ndërkulturor, ndikimi i kulturës në biznes
	Java - V	Strategjitë e menaxherëve në realitetin e ekonomisë globale, në këndvështrimin multikulturor.
	Java - VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore, në këndvështrimin e menaxhimit ndërkulturor
	Java - VII	Testi i parë
	Java - VIII	Vendosja e objektivave, matja e performancës dhe kultura e punës
	Java - IX	Menaxhimi i diversitetit, ekipet multikulturore

	Java - X	Lidershipi dhe kultura në realitetin e ekonomisë globale
	Java - XI	Negociatat dhe Kultura. Sjellja konfliktuozë dhe kultura
	Java - XII	Motivimi dhe kultura
	Java - XIII	Krijimi i sinergjisë kulturore dhe punës ekipore multikulturore
	Java - XIV	Sllogani i menaxhimit: Mendo globalisht, planifiko lokalisht dhe vepron individualisht
	Java - XV	Testi i dytë
LITERATURA	Literaturë bazë: 1. Beer, L. A. (2012). Essential Concepts of Cross-Cultural Management : Building on What We All Share (Vol. 1st ed). [New York, N.Y.] [222 East 46th Street, New York, NY 10017]: Business Expert Press. 2. Cross-Cultural Management: With Insights from Brain Science (2020), Mai Nguyen-Phuong-Mai, 1st Edition, Routledge International Business Studies, New York, ISBN-13: 978-1138304659 3. Cultures and Organizations, Software of the mind. Intercultural Cooperation and Its Importance for survival. (2010). McGraw-Hill.	

METOD OLOGJI A E MËSIM DHËNJË S	15 javë me 2 orë ligjerata dhe 1 ushtrime (raste studimore, seminare dhe diskutime) si dhe dy kollokfiime janë planifikuar brenda këtij semestri. Kollokiumet do të mbahen brenda 15 javëve të planifikuara (java 7 dhe 15). Çdo orë do të përbëhet nga një kombinim i ligjëratave të shkurtra, studimeve të rasteve, diskutimeve në grupe të vogla dhe / ose filma dhe dokumentarë, në varësi të materialit në dispozicion. Studentët inkurajohen të ndjekin zhvillimet aktuale të globalizimit, diversitetit kulturor, si dhe ndikimit të tij në performancën e biznesit duke lexuar artikuj relevantë, gazeta ekonomike dhe materiale të tjera. Ata mund të identifikojnë çështjet / temat për diskutime nga këto lexime. Më pas diskutohen esetë e përgatitura nga studentët. Duke pasur parasysh se pjesëmarrja e studentëve në diskutime është e rëndësishë të veçantë, ata inkurajohen të diskutojnë duke u rikujtuar atyre se nuk ka përgjigje "të drejtë" ose "të gabuar" kur diskutojnë temat. Në pjesën më të madhe të kohës, çështjet duhet të diskutohen dhe të ballafaqohen dhe nuk kanë zgjidhje të thjeshta dhe të menjëhershme. E rëndësishme është që studentët të mendojnë si menaxher të kompanisë në mjedisin global dhe të tentojnë të gjejnë zgjidhje për çështjet dhe temat e trajtuara. Studentët do të ndahen në grupe pune. Ata do të kenë detyra individuale dhe një detyrë në grup. Ata do të prezantojnë punimet e tyre individuale si dhe ato ekipore, e gjithashtu do të vlerësojnë dhe kritikojnë njëri tjetrin. Gjatë kursit do të organizohet vizitë e ndonjë ndërmarrje multikulturore. Sipas mundësisë, do të ftohen në ligjërata edhe menaxher global të suksesshëm si guest speaker, të cilët do të ndajnë përvojat e tyre me studentë. Raporti midis pjesës teorike dhe praktike të studimit Teorikisht, do të sigurohet njohuri e përgjithshme shkencore e bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike do të realizohet kryesisht përmes shembujve konkretë nga literatura dhe njohuritë praktike të ndërmarrjeve private dhe publike të prodhimit dhe organizatave fitimprurëse. Marrëdhënia midis pjesës teorike dhe asaj praktike jepet në pjesën tabelare të programit të studimit. Raporti teori-praktike: 60% teori dhe 40% praktikë / studim rasti / punim seminarik (projekti), vizitë ndërmarrjes etj.
--	---

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime teorike	1	15	15
	Ushtrime në terren	1	6	6
	Punë praktike	1	6	6
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	2	10	20
	Kolokiume /seminare	1	2	2
	Detyra të pavarura	1	5	5
	Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
	Përgatitja përfundimtare për provim	1	10	10
	Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz, provim final)	1	5	5
	Projektet, prezantimet, etj	1	5	5
	Total:			109
VLERËS IMI	Metodat e vlerësimit			
	[sipas Statutit dhe Rregullores për studime të UMIB-it]			
	Testet/Kollokviumet	2*20%=40%		
	Test praktik gjatë ushtrimeve			
	Punim seminarik	10%		
	Interpretimi dhe prezentimi i punimit seminarik	10%		
	Detyrat dhe kurset gjatë semestrit	10%		
	Provimi final	30%		

POLITI KAT AKADE MIKE	Udhëzime të mëtejme : ● Puna me kompjuter Punimet me shkrim duhet doemos të jenë të shkruara me kompjuter. Në punime janë të obligueshme respektimi i kriterëve qoftë për aspektin vizual ashtu edhe përmbajtjesor të punimeve të kërkuara. Gjatë punimeve kërkohet që të respektohen rregullat drejtshkrimore dhe stili APA ● Etika në mësim Punimet e ndryshme semestrale duhet të jenë punime të secilit student. Nuk do të ketë tolerancë për kopjime, “huazime” nga interneti apo çfarëdo materiali tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjashme do të kenë vlerësime negative në vlerësimin përfundimtar të studentit. ● Afatet Në marrëveshje me studentët do të përcaktohen afatet e dorëzimit të punimeve. Nuk do të ketë tolerancë për vonesë në dorëzimin e punimeve. Mosardhja në orën kur është shpjeguar detyra nuk e arsyeton studentin për mosdorëzim të punimit. Afati do të jepet më herët. Po qe se do të udhëtoni jashtë vendit, atëherë duhet të dorëzoni punimi më herët. Studenti/ja ka të drejtë të kërkojë konsultim me profesorin sa herë e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme për kryerjen e punimit të tij/saj. ● Rregullat e mirësjelljes dhe politikat akademike : - o pjesëmarrje aktive e studentëve në ligjërata - o pjesëmarrje në diskutim, komente dhe shprehje e lirë e opinionit, mendimit dhe qëndrimit akademik (me argumente) - o e obligueshme puna e pavarur dhe shfrytëzimi i burimeve shtesë të informacionit (web-faqet e ndryshme shkencore, revista shkencore, përmbledhje punimesh të konferencave etj.) - o respektimi i orareve të ligjëratave pa cenuar lirinë akademike (telefonat celularë pa zë) - o respektimi i fjalës, mendimeve dhe ideve të kolegëve - o tolerancë e ulët ndaj ardhjeve me vonesë dhe daljeve pa ndonjë arsye të qëndrueshme - o përgatitja dhe pajisja me ligjëratat përkatëse, (obligim i mësimdhënësit).
--	---

Mitrovicë

03 / 01 / 2022

Profesori i lëndës:

Prof. Ass. Dr. Ajtene Avdullahi

(Name Surname)

(Signature)